

Angazhimi për veprim të përbashkët - EJA Kosovë

*Udhëzues për aplikim për grante për
Zhvillim Organizativ*

Rreth angazhimit për veprim të përbashkët - EJA Kosovë



Angazhimi për Veprim të Përbashkët (EJA Kosovë) është program i KCSF-së që mbështet nismat e shoqërisë civile përmes granteve dhe ngritjes së kapaciteteve me synimin e përgjithshëm për të dhënë kontribut domethënës në zhvillimin demokratik dhe socio-ekonomik të Kosovës. E themeluar si mekanizëm i financimit ku disa donatorë i bashkojnë fondet e tyre për përkrahjen e shoqërisë civile, EJA Kosovë aktualisht financohet bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Duke vënë në plan të parë angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punën e shoqërisë civile, EJA Kosovë synon të kontribuojë drejt dy objektivave kryesorë (a) rritjes së angazhimit të qytetarëve në jetën publike përmes avokimit me pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe (b) t'u mundësohet OSHC-ve që t'i forcojnë marrëdhëniet e tyre me qytetarët dhe t'i përmirësojnë kapacitetet organizative.

EJA Kosovë bazohet në premisën që përmes sistemeve të përshtatura të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies nga njëra anë, dhe qasjes dhe komunikimit më të mirë me komunitetin, nga ana tjetër, OSHC-të, duke i përfshirë qytetarët në punën e tyre, mund të ndërtojnë bazë më të fortë dhe më të angazhuar të mbështetjes. Kjo forcon qytetarët dhe mundëson që ato t'i përfaqësojnë më mirë nevojat dhe shqetësimet e komunitetit. Së bashku me qeverisje të brendshme, transparencë dhe angazhim më të mirë të qytetarëve, kjo do të kontribuojë në rritjen e besimit publik në OSHC-të. Qytetarët i shohin ato si platformë legjitime dhe efektive për ngritjen e shqetësimeve dhe avokimin për ndryshim.

1. Hyrje



Pikëpamja tradicionale e politikëbërjes fokusohet në proceset formale ligjore dhe normative. Megjithatë, politikëbërja efektive shtrihet përtej këtyre strukturave. Ajo përfshin të gjitha aspektet e shoqërisë dhe jetës publike, duke siguruar që zërat dhe nevojat e të gjithë qytetarëve të dëgjohen dhe të merren parasysh. Çdo burrë dhe grua, djalë dhe vajzë kosovare duhet të ketë mundësinë që t'i adresojë nevojat, shqetësimet dhe propozimet e tij/saj në mënyrën më adekuate për kapacitetet, nevojat dhe kontekstin e tij/saj. Shoqëria civile ka mundësi, por edhe përgjegjësi, për t'i fuqizuar qytetarët dhe për t'i sjellë shqetësimet dhe zërin e tyre në qendër të vëmendjes së politikave publike dhe diskursit publik.

a. Instrumentet e mbështetjes të EJA Kosovë

Duke njohur diversitetin e shoqërisë civile dhe qasjet e saj të ndryshme, EJA Kosovë fokusohet veçanërisht në nismat dhe individët që përfshijnë në punën e tyre praktikën me pjesëmarrje. Ky fokus bazohet në besimin se shoqëria civile mund t'u përgjigjet vërtet nevojave të qytetarëve vetëm duke i përfshirë ata në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme në aktivitetet e saj. Një përfshirje e tillë jo vetëm që rrit ndikimin, transparencën dhe llogaridhënien, por gjithashtu përmirëson praktikën e qeverisjes së brendshme përtej thjeshtë punës me dokumente. Duke u mbështetur në kapacitetet dhe përvojën ekzistuese brenda shoqërisë civile, EJA Kosovë synon ta ngushtojë hendekun ndërmjet shoqërisë civile dhe qytetarëve, duke rritur kështu legjitimitetin dhe ndikimin e saj.

Për t'i mbështetur këto synime, EJA Kosovë ofron disa mekanizma mbështetës: Grante Institucionale, Grante për Zhvillim Organizativ, Grante për Projekte, Grante Urgjente dhe Çmimin Vjetor për Demokraci. Çdo instrument është dizajnuar për të adresuar nevoja specifike brenda shoqërisë civile, duke siguruar që një spektër i gjerë nismash mund të gjejë mbështetjen që u nevojitet.

b. Grantet për zhvillim organizativ (GZHO)

EJA Kosovë beson se OJQ-të kanë potencial për të kontribuar në shumë fusha. Ky potencial zakonisht vërehet në OJQ-të e konsoliduara, që kanë një vizion të qartë dhe punojnë sistematikisht për të zbatuar strategjinë e tyre. Megjithatë, ka edhe OJQ të tjera që nuk janë ende në atë nivel të konsolidimit, por kanë drejtim të qartë të zhvillimit të tyre, përfshirë qëllimet programore dhe grupet e qytetarëve të cilët i përfaqësojnë ose i synojnë me punën e tyre. Sidoqoftë, ky potencial nuk është shfrytëzuar plotësisht pasi struktura e financimit që kanë nuk mbështet zhvillimin organizativ. Ky zhvillim pengohet nëse organizatat zbatojnë vetëm aktivitete të projekteve të shkurta dhe strikte pa ndonjë mundësi për të kontribuar në rritje të organizatës, ndërtim të kapaciteteve dhe avancim të sistemeve të brendshme. Në mënyrë që të kompensojnë këtë mungesë fondesh që nuk e favorizon zhvillimin organizativ, këto OJQ shpesh janë të detyruara të përdorin burime të brendshme edhe ashtu të kufizuara ose fonde në kuadër të ndonjë projekti që nuk janë të parapara drejtpërdrejt për atë qëllim.

Duke marrë mbështetje për zhvillim organizativ të përshtatur për nevojat dhe karakteristikat e veçanta të tyre, organizatat e synuara do të mund të përdorin këto fonde të dedikuara për zhvillimin e organizatës në vend të atyre për zbatimin e projekteve specifike. Në veçanti, këto grante synojnë të mbështesin ndërtimin e kapaciteteve të stafit, zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve dhe procedurave të brendshme, zhvillimin e politikave dhe dokumenteve të brendshme, përdorimin e softuerëve dhe pajisjeve ose metodologjive dhe qasjeve specifike. Ngjashëm me instrumentet tjera të EJA Kosovë, këto grante u mundësojnë organizatave që gjithashtu të adresojnë në mënyrë të vazhdueshme e sistematike përfshirjen e qytetarëve në punën e tyre dhe t'i përmirësojnë praktikën e qeverisjes së brendshme.

2. Përmbledhje e përgjithshme e kërkesave të thirrjes



a. Kriteret e kualifikueshmërisë

In order to be eligible for application, applicants need to fulfil the following criteria:

- o Për t'u kualifikuar për aplikim, organizatat aplikuese duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- o Të jetë organizatë joqeveritare vendore e regjistruar sipas ligjit në fuqi në Kosovë (**degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë nuk kualifikohen për aplikim**);
- o Të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin e grantit;
- o Të demonstrojë kapacitet për menaxhimin e grantit të propozuar;
- o Të demonstrojë trend pozitiv të zhvillimit sa i përket kapaciteteve të brendshme ashtu edhe për strategjinë programore, sipas qëllimeve dhe objektivave të mbështetjes së mëparshme (për përfituesit e mëparshëm të çfarëdo lloji granti nga KCSF gjatë periudhës 2015–2025.);
- o Nuk drejtohet apo menaxhohet nga Persona të Ekspozuar Politikisht (PEP-të)¹;
- o Pranon dhe zotohet t'u përmbahet [Vlerave Themelore](#) për përfituesit e grantit të EJA².

b. Organizatat Joqeveritare

Aplikantët duhet të demonstrojnë se angazhimi i tyre është brenda fushës së demokritizimit dhe fushave të kualifikueshme të programit. Pavarësisht statusit të tyre ligjor, jo të gjitha OJQ-të janë të përfshira në kriteret e mësipërme të kualifikueshmërisë për shkak të fushëveprimit të gjerë të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e OJQ-ve në Kosovë.

Klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore apo organizatat fetare që janë të regjistruara si OJQ nuk kualifikohen për grante të KCSF-së. Ngjashëm, OJQ-të që përfaqësojnë biznese ose subjekte të ngjashme me kapacitet të qartë financiar për t'i mbuluar shpenzimet e organizatës së tyre ose për t'i mbajtur aktivitetet e tyre nuk kualifikohen për grante të KCSF-së.

c. Numri i aplikimeve

Organizatat mund të dorëzojnë vetëm një aplikacion në këtë Thirrje për Propozime.

d. Afati kohor dhe buxheti

Organizatat mund të aplikojnë për financim për një periudhë minimale 6 muaj dhe një periudhë maksimale deri në 12 muaj. Buxheti maksimal i kërkuar për financim nga kjo thirrje nuk duhet të kalojë 15,000 euro.

e. Fushat e ndërhyrjes dhe popullsia e synuar

Ndërsa Grantet për Zhvillim Organizativ synojnë të mbështesin në mënyrë specifike aktivitetet e destinuar për zhvillimin e brendshëm të organizatës, supozimi është se përmes përmirësimit të sistemeve të tyre të brendshme ato do të rrisin cilësinë e punës së tyre dhe në këtë mënyrë do të kontribuojnë në objektivat e programit EJA Kosovë. Prandaj, angazhimi i organizatave përfituese të Granteve për Zhvillim Organizativ pritet të jetë në përputhje me fokusin programor të mëposhtëm.

1- Për më shumë mbi kufizimet në lidhje me Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP-të), shih formularin për aplikim. Të gjitha organizatat që aplikojnë duhet të deklarojnë se asnjë nga personat në pozitë drejtuese, sipas përkufizimit të Personave të Ekspozuar Politikisht, nuk i përket kësaj kategorie.

2- Për më shumë rreth Vlerave Themelore për grante të EJA, shih formularin për aplikim. Të gjitha organizatat aplikuese janë të detyruara që t'i pranojnë dhe t'i përkushtohen që do t'i përmbahen Vlerave Themelore për grante të EJA.

2. Përmbledhje e përgjithshme e kërkesave të thirrjes



EJA Kosovë fokusohet në kontributin e shoqërisë civile në hartimin e politikave, duke vënë theksin në integrimin e qytetarëve në përpjekjet për avokim dhe krijimin e hapësirave dhe praktikave për angazhimin e qytetarëve. Programi synon rritjen e pjesëmarrjes qytetare në proceset e politikave publike në të gjitha nivelet, me fushat me prioritet që përfshijnë pjesëmarrjen e grave dhe grupeve të marginalizuara, përmirësimin e të drejtave socio-ekonomike dhe kulturore, forcimin e rolit mbikëqyrës të shoqërisë civile, fuqizimin e të rinjve në proceset e politikave dhe edukimin qytetar për të drejtat e njeriut. Programi thekson aktivitetet e mbikëqyrësit, monitorimin e zbatimit të politikave dhe adresimin e temave të diskutueshme, siç janë çështjet mjedisore dhe përfaqësimi i grupeve të marginalizuara.

EJA Kosovë zotohet t'i mbështesë nismat e fokusuara në adresimin e të drejtave dhe nevojave të grupeve të marginalizuara. Këtu përfshihen gratë, personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike:romët, ashkalinjtë, egjiptianët, serbët, komuniteti LGBTI, të moshuarit dhe të rinjtë.

f. Niveli i ndërhyrjes dhe mbulueshmëria gjeografike

Përmes kësaj thirrjeje do të ofrohet mbështetje për OJQ-të në mbarë Kosovën që synojnë të sjellin transformime në nivel lokal/komunal dhe/ose kombëtar/qendror. Në veçanti, së paku 30 për qind e përfituesve të granteve për zhvillim organizativ do të jenë organizata të bazuara dhe që operojnë jashtë Prishtinës.

g. Angazhimi qytetar

Angazhimi qytetar - EJA Kosovë thekson angazhimin e qytetarëve gjatë gjithë punës së organizatave të mbështetura. Aplikantët për grante për zhvillim organizativ pritet të demonstrojnë qartë se si do t'i përfshijnë qytetarët në strategjitë e tyre aktuale dhe punën e ardhshme.

Analiza e grupit të synuar - Aplikantët duhet ta paraqesin një analizë të qartë të grupit të tyre të synuar, arsyen pse angazhimi dhe pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme për punën e organizatës dhe projektin në veçanti si dhe mënyrat e ndryshme në të cilat synojnë t'i angazhojnë grupet e synuara. Në analizën e grupit të tyre të synuar, aplikantët **pritet të njohin dallimet e atyre grupeve** (si gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja, arsimit, vendndodhja, rrethanat socio-ekonomike, interesat dhe nevojat e ndryshme) dhe t'i përshtatin propozimet dhe intervenimet e tyre sipas nevojave.

Strategjitë e angazhimit - Aplikantët gjithashtu pritet ta analizojnë potencialin për angazhim të grupeve të synuara dhe ta zhvillojnë një qasje realiste për rritje graduale por sistematike, të përfshirjes së tyre në punën e organizatës.

Përvoja e mëparshme me KCSF-në - Nëse aplikantët janë përfitues të mbështetjes së mëparshme nga KCSF-ja në periudhën 2015-2025 (pavarësisht programit dhe instrumentit të grantit), ata duhet të paraqesin një përmbledhje të aktiviteteve të zhvillimit të brendshëm të mbështetura nga KCSF-ja, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, rekomandimet e monitorimit të KCSF-së, dhe se si secili prej tyre është adresuar nga aplikanti.

2. Përmbledhje e përgjithshme e kërkesave të thirrjes



OJQ-të do të kenë qasje në mentorim dhe ndërtim të kapaciteteve për avokimin pjesëmarrës dhe mobilizimin e komunitetit, i cili do të sigurojë ndihmë në zhvillimin e planit për përfshirjen e qytetarëve mbi përvojën e tyre të mëparshme të paraqitur në aplikacion.

Për udhëzime lidhur me përfshirjen e qytetarëve, ju lutemi shikoni dokumentin e shkurtër Udhëzues për aplikantët: Përfshirja e qytetarëve në webfaqen e KCSF së.

h. Qeverisja e brendshme

Qeverisja e brendshme e OJQ-ve është një aspekt i rëndësishëm në përpjekjet për të përmirësuar dhe ngritur besimin e qytetarëve në sektorin e shoqërisë civile dhe për të qenë në gjendje të udhëheqin duke qenë shembull për qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie ndaj publikut në përgjithësi. Të gjithë aplikantët duhet të japin informacion mbi mekanizmat e kontrollit të brendshëm, strukturat e menaxhimit dhe qeverisjes, procesin e vendimmarrjes dhe menaxhimin financiar.

Aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen një verifikimi të thellë gjatë vizitave nga KCSF-ja, ku duhet të paraqiten dokumentet mbështetëse për të gjitha kategoritë e lartpërmendura. Nëse aplikantët janë përfitues të mbështetjes së mëparshme nga KCSF-ja në periudhën 2015-2025 (pavarësisht programit dhe instrumentit të grantit), ata duhet të paraqesin një përmbledhje të aktiviteteve të zhvillimit të brendshëm të mbështetura nga KCSF-ja, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, rekomandimet e monitorimit të KCSF-së, dhe se si secili prej tyre është adresuar nga aplikanti.

Pas vlerësimit fillestar, KCSF-ja do të bëjë punë intensive me organizatat e mbështetura për të zhvilluar mentorim të përshtatur për t'i adresuar praktikatat e identifikuara të qeverisjes së mirë, menaxhimin e qëndrueshëm financiar dhe parimet e transparencës, luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit dhe llogaridhënien.

i. Grupet e bashkëpunimit/rrjetëzimit

Për të nxitur bashkëpunim më të madh dhe veprim të përbashkët ndërmjet OJQ-ve, EJA Kosovë do të ofrojë platforma të ndryshme dhe vende takimesh ku OJQ-të mund të takohen, shkëmbejnë dhe ndajnë përvoja mes njëra-tjetrës. Bashkëpunimi për çështje me interes të përbashkët do të ishte një rezultat i synuar, prandaj pritet që organizatat e mbështetura të jenë proaktive në identifikimin dhe kontributin në mobilizimin e nismave të tjera të shoqërisë civile në fushat me interes për to.

Ngjarjet tematike paraqesin një platformë e cila do të jetë në dispozicion të të gjitha organizatave të mbështetura për të propozuar çështje përkatëse në fushëveprimtarinë e tyre dhe/ose çështje që nuk bien drejtpërdrejt në fushëveprimatrinë e tyre, por që konsiderohen të rëndësishme, urgjente dhe relevante. Meqenëse objektivi i EJA Kosovë është të zgjerojë aktivitetin e shoqërisë civile në mbarë vendin dhe të kontribuojë në krijimin e lidhjes me qytetarët, këto ngjarje tematike synohen të organizohen kryesisht jashtë Prishtinës.

2. Përmbledhje e përgjithshme e kërkesave të thirrjes



j. Çështjet horizontale

Integrimi gjinor, përgjegjësia ndaj mjedisit dhe të drejtat e njeriut do të jenë çështje ndërthurëse dhe horizontale të integruara në të gjitha ndërhyrjet. Integrimi gjinor si një mjet drejt barazisë gjinore kërkon që të gjitha organizatat e mbështetura të sigurojnë që ndërhyrjet e tyre të marrin parasysh në mënyrë të barabartë efektet te burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat dhe të shmangin kontributin në stereotipe të dëmshme. Konsideratat mjedisore kërkojnë që të gjitha ndërhyrjet të kenë parasysh ndikimin e tyre në mjedis, duke promovuar qëndrueshmërinë dhe duke minimizuar efektet negative në mjedis. Parimet e të drejtave të njeriut do t'i udhëheqin të gjitha aktivitetet për të siguruar që në ato aktivitete respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe dinjiteti i të gjithë individëve të përfshirë, duke shmangur çdo formë diskriminimi ose padrejtësie.

k. Diversifikimi i burimeve

Diversifikimi i burimeve është një komponent kritik i garantimit të qëndrueshmërisë dhe pavarësisë së organizatave të shoqërisë civile. Ai përfshin eksplorimin dhe krijimin e burimeve të ndryshme të financimit dhe qasjeve novatore për të gjeneruar të ardhura, duke reduktuar mbështetjen në burime të vetme financimi. Duke qenë se donatorët e huaj janë vazhdimisht burimi kryesor i financimit për shumicën e OJQ-ve kosovare që punojnë në fushën e demokratizimit, diversifikimi i burimeve synon të kontribuojë në zgjerimin e bazës së burimeve në sektorë të tjerë, në veçanti kontributet nga sektori privat, diaspora dhe/ose qytetarët, apo aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave.

Përmes Grantit për Zhvillim Organizativ, aplikantët inkurajohen jo vetëm të hartojnë, por edhe të pilotojnë dhe testojnë mekanizma konkretë për diversifikimin e burimeve, të përshtatur me kontekstin organizativ dhe kapacitetet e tyre. Kjo mund të përfshijë zhvillimin dhe/ose zbatimin e planeve specifike, metodologjive, strategjive të mbledhjes së fondeve për sigurimin e burimeve alternative të të ardhurave, partneriteteve, apo modeleve inovative të mbledhjes së fondeve, me synim forcimin e bazës së burimeve dhe qëndrueshmërisë së organizatës në afat të gjatë.

3. Kualifikueshmëria e Aktiviteteve dhe Shpenzimeve

Buxheti i propozuar do të përdoret ekskluzivisht për zhvillim organizativ, dhe i cili përfshin por nuk kufizohet në ndërtimin e kapaciteteve, avancimin e sistemeve të brendshme, zhvillimin e politikave dhe dokumenteve të brendshme, softuerëve dhe pajisjeve ose metodologjive dhe qasjeve specifike të punës. Nga ky grant nuk do të mbulohen pagat, përveç në rastet kur një përqindje e caktuar e kohës së një anëtari të stafit i dedikohet specifikisht menaxhimit të aktiviteteve të zhvillimit organizativ. Nga ky grant nuk do të mbulohen shpenzimet administrative, përveç shpenzimeve që janë dedikuar posaçërisht për aktivitetet e grantit për zhvillim organizativ dhe/ose personelit të angazhuar specifikisht në menaxhimin e aktiviteteve të zhvillimit organizativ. Në rastet kur aplikohet me buxhet që i përfshin këto dy kategori buxhetore (1) Burimet njerëzore dhe (3) Shpenzimet administrative dhe për zyre, buxheti i kërkuar për këto kategori së bashku **nuk duhet të kalojë 20% të shumës totale të grantit.**

a. Ndërhyrjet/aktivitetet jo të kualifikueshme

Aktivitetet në vijim nuk do të mbështeten:

- o Të gjitha aktivitetet të cilat nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin organizativ;
- o Aktivitete në të cilat organizata përfituese shërben vetëm si ndërmjetës për palët e treta;
- o Aktivitete të zhvillimit organizativ por që kanë shumë nivele të aprovimit nga palë të treta e që rrjedhimisht përmbajnë në vete rrezik të lartë gjatë zbatimit dhe arritjen e rezultateve;
- o Aktivitetet që drejtpërdrejt lidhen me partitë politike ose që i mbështesin ato;
- o Ndërhyrjet që janë në kundërshtim me vlerat themelore për përfituesit e granteve të EJA;
- o Investimet kapitale;
- o Grantet e përbëra tërësisht ose kryesisht nga punë përgatitore dhe/ose studime;
- o Aktivitetet e llojit të shërbimit, si ato të ngjashme me Asistencën Teknike;
- o Fushata ndërgjegjësuere pa veprime të duhura pasuese;
- o Nëngrante për palët e treta;
- o Bursat.

Përveç nëse ato janë të domosdoshme për arritjen e objektivave të synuara të strategjisë organizative, në parim, aktivitetet e përshkruara më poshtë nuk do të mbështeten:

- o Konferenca, diskutime në tryeza të rrumbullakëta ose ngjarje të tjera të ngjashme në vende (si hotele) që nuk janë të hapura dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët e zakonshëm;
- o Hulumtim dhe studime të fizibilitetit, veçanërisht si një mjet për të hartuar pjesën tjetër të ndërhyrjes;
- o Udhëtime studimore jashtë Kosovës.

3. Kualifikueshmëria e Aktiviteteve dhe Shpenzimeve



b. Kostot e kualifikueshme

Për t'u konsideruar të kualifikueshme, kostot duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- o të jenë të nevojshme për zbatimin dhe arritjen me sukses të rezultateve të treguara të ndërhyrjes;
- o të jenë të arsyeshme, të justifikuara dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar, duke përfshirë llogaritjet e drejta dhe të bazuara në treg dhe efikasitetin e kostos;
- o t'i përmbushin kërkesat e legjislacionit tatimor në fuqi në Kosovë;
- o të ndodhin gjatë zbatimit të grantit;
- o të tregohen në buxhetin e miratuar;
- o të jenë të identifikueshme dhe të gjurmueshme.

c. Kostot e jokualifikueshme

Kostot e paraqitura më poshtë konsiderohen jo të kualifikueshme:

- o Pagat e stafit, përveç në rastet kur një përqindje e caktuar e kohës së një anëtari të stafit i dedikohet specifikisht menaxhimit të aktiviteteve të zhvillimit organizativ³;
- o Shpenzimet administrative, përveç shpenzimeve që janë dedikuar posaçërisht për aktivitetet e grantit për zhvillim organizativ dhe/ose personelit të angazhuar specifikisht në menaxhimin e aktiviteteve të zhvillimit organizativ;
- o Renovime/ndërrhyrje në objekt/zyre;
- o Blerja e pajisjeve të cilat nuk janë të domosdoshme për zhvillimin organizativ të synuar;
- o Taksat doganore dhe të importit;
- o Borxhi ose pagesat për humbje;
- o Tatimi mbi vlerën e shtuar - TVSH (për faturat mbi 200 EUR);
- o Pagesat e huasë dhe të interesit;
- o Tarifat e këmbimit të valutave;
- o Shpenzimet e amortizimit të pajisjeve;
- o Blerja e tokës ose pronës së paluajtshme;
- o Blerja e automjetit ose gjeneratorit;
- o Pagesat e shpenzimeve që mbulohen nga donatorë të tjerë;
- o Kredi për palët e treta;

4. Procedura e aplikimit



a. Dorëzimi i aplikacioneve

Të gjitha aplikacionet për grante të EJA Kosovë duhet të dorëzohen përmes platformës online.

Aplikantët duhet t'i japin informatat e tyre, ta shtjellojnë idenë dhe t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme përmes sistemit të aplikimit online.

Për udhëzime mbi regjistrimin dhe përdorimin e sistemit online të aplikimit, ju lutemi referojuni informacionit në dispozicion në faqen e internetit të sistemit online të aplikimit.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me regjistrimin ose aplikimin për grant, ju lutemi na dërgoni e-mail në aja@kcsfoundation.org. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet në lidhje me aplikacionin do të publikohen në seksionin pyetje dhe përgjigje të faqes së internetit të KCSF-së. Aplikantët këshillohen ta kontrollojnë rregullisht këtë seksion.

Ne i inkurajojmë fuqimisht aplikantët t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre shumë përpara afatit për ta shmangur çdo vështirësi teknike të minutës së fundit për shkak të trafikut të madh të internetit ose ndonjë defekti me lidhjen e internetit (përfshirë dështimin e energjisë elektrike, etj.), ose trafikun e madh të internetit në sistemin online të aplikimit që mund të çojë në vështirësi në dorëzim. KCSF-ja nuk mund të mbajë përgjegjësi për ndonjë vonesë për shkak të vështirësive të lartpërmendura.

b. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është data **28 qershor 2026 në orën 23:59**. Aplikacionet e marra pas afatit nuk do të merren parasysh.

c. Kontakti

Për pyetje në lidhje me procesin e aplikimit mund të na kontaktoni në aja@kcsfoundation.org jo më vonë se **19 qershor 2026**. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në seksionin pyetje dhe përgjigje të faqes së internetit të KCSF-së jo më vonë se **23 qershor 2026**.

Ju lutemi përdoreni vetëm këtë e-mail për komunikim me KCSF-në lidhur me procesin e aplikimit.

Aplikuesit nuk duhet të kontaktojnë ose në çfarëdo mënyrë të provojnë të ndikojnë këdo që është i përfshirë në vlerësimin e aplikimit të tyre, përfshirë stafin e KCSF-së ose Ekipin për Vlerësim të Granteve, sepse kjo mund të rezultojë në refuzimin e aplikimit, ose në rast të dhënies së grantit edhe në ndërprerje të kontratës.

4. Procedura e aplikimit



Dokumentet e detyrueshme në fazën e aplikimit

Përveç formularit të aplikimit për grant për zhvillim organizativ, aplikantët duhet t'i ngarkojnë në sistemin online të aplikimit dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-ve e lëshuar nga Departamenti i OJQ-ve;
2. Deklarata për Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP) (nënshkruhet sipas shabllonit të EJA Kosovë në pjesën e fundit të formularit të aplikimit në sistemin online të aplikimit);
3. Deklarata mbi vlerat themelore për grantmarrësit e EJA (nënshkruhet sipas shabllonit të EJA Kosovë në pjesën e fundit të formularit të aplikimit në sistemin online të aplikimit);
4. Buxheti i propozuar për zhvillimin organizativ (sipas shabllonit të EJA Kosovë i qasshëm në sistemin online të aplikimit);
5. Plani i aktiviteteve për aktivitetet e zhvillimit organizativ (sipas shabllonit të EJA Kosovë i qasshëm në sistemin online të aplikimit);
6. Korniza logjike për aktivitetet e zhvillimit organizativ (sipas shabllonit të EJA Kosovë i qasshëm në sistemin online të aplikimit).

Dokumentet e detyrueshme pas përzgjedhjes në listën e ngushtë

Për ata aplikantë që do të përfshihen në listën e ngushtë, dokumentet e mëposhtme që do të dorëzohen si dokumente të veçanta pas njoftimit për përzgjedhje në listën e ngushtë:

1. Statuti i organizatës (versioni i nënshkruar identik me Statutin siç është dorëzuar në Departamentin e OJQ-ve);
2. Në rast se aplikanti është fondacion ose institut, listën e anëtarëve të Bordit Drejtues;
3. Në rast se aplikanti është shoqatë, emri i Kryetarit të Kuvendit dhe listën e anëtarëve të Kuvendit. Gjithashtu, nëse shoqata ka ndonjë bord ndërmjetësues apo organe të tjera, listën e anëtarëve të këtij organi;
4. Pasqyrat financiare vjetore të organizatës për dy (2) vitet e fundit (2024 dhe 2025)⁴;
5. Raportet e auditorit për dy (2) vitet e fundit (2024 dhe 2025), nëse organizata aplikuese është e detyruar ligjërisht të posedojë raportin e auditimit, ose nëse organizata e ka atë pavarësisht nga detyrimet ligjore).

4- Pasqyrat financiare vjetore duhet në minimum të tregojnë bilancin dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Raportet e auditimit duhet të mbulojnë dy pasqyra financiare të organizatës. Për organizatat e krijuara së fundmi, vetëm nëse është e aplikueshme.

5. Vlerësimi dhe njoftimi



Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet në dy faza:

- 1) Kontrolli administrativ (verifikimi i kriterëve formale) dhe
- 2) Vlerësimi i përmbajtjes (bazuar në kategoritë dhe kriteret e vlerësimit).

a. Kontrolli administrativ (verifikimi i kriterëve formale)

Të gjitha aplikacionet vlerësohen gjatë kësaj faze për të parë nëse kriteret në vijim janë respektuar/dorëzuar:

1. Afati për dorëzimin e aplikimit;
2. Të gjitha kërkesat administrative dhe teknike të paraqitura në formularin e aplikimit;
3. Dokumentet e detyrueshme, përfshirë edhe pranueshmërinë e organizatave;
4. Shumën e kërkuar; dhe
5. Kohëzgjatjen e grantit.

Aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret e specifikuar do të refuzohen automatikisht. Rezultatet e përputhshmërisë me kriteret administrative i komunikohen secilit aplikant me shkrim.

b. Vlerësimi i aplikacioneve dhe vendimi përfundimtar

Aplikacionet që e kalojnë pajtueshmërinë administrative do të vlerësohen nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve (EVG), i përbërë nga pesë ekspertë të jashtëm me ekspertizë dhe njohuri përkatëse.

Anëtarët e EVG-së do t'i vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve dhe peshës si vijon:

1. **Cilësia dhe rëndësia e qëllimeve dhe drejtimin programor të organizatës (15%);**
2. **Cilësia e dizajnit të zhvillimit organizativ (duke përfshirë vetëvlerësimin bazë dhe relevancën e tyre në raport me qëllimet programore dhe drejtimin e organizatës) (40%);**
3. **Përfshirja e qytetarëve/grupeve të synuara në punën e organizatës (15%);**
4. **Çështjet horizontale (10%);**
5. **Niveli i kapacitetit organizativ dhe qeverisjes së brendshme (10%);**
6. **Efikasiteti i shpenzimeve të buxhetit të propozuar (10%);**

Vlerësimi maksimal për aplikacion është 100 pikë.

EVG do t'i vlerësojë aplikacionet në dy faza, përmes:

- 1) shqyrtimit të dokumenteve dhe
- 2) intervistave publike

Pas vlerësimit fillestar të aplikacionit të dorëzuar dhe të gjitha dokumenteve të detyrueshme, **aplikantët që marrin së paku 61 pikë (nga gjithsej 100)**, si dhe gjysmën e pikëve në dispozicion (50%) në secilën nga të gjashtë kategoritë e paraqitura më lart, do të për zgjidhen në listën e ngushtë.

5. Vlerësimi dhe njoftimi



KCSF do të organizojë vizita në të gjitha organizatat e përzgjedhura në listën e ngushtë, përveç atyre organizatave të cilat i janë nënshtruar një vizite të ngjashme nga KCSF gjatë vitit të kaluar dhe të cilave do t'u kërkohet një konfirmim me shkrim se nuk ka ndryshime të rëndësishme në gjetjet e vizitës së fundit. Përpara vizitës në zyre, aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë do t'u kërkohet të dorëzojnë dokumente dhe informacione shtesë në lidhje me qeverisjen e brendshme.

Vizita e stafit të KCSF-së do të përqëndrohet në qeverisjen e brendshme dhe menaxhimin financiar, si dhe konfirmimin e adresimit të rekomandimeve për grantmarrësit e mëparshëm të KCSF-së. Pas vizitës dhe çdo konfirmimi shtesë vijues, KCSF përgatit një raport për secilën organizatë në listën e ngushtë, me kategoritë e mëposhtme të vlerësimeve:

- o **Shumë mirë**, në rastet kur të gjithë ose pothuajse të gjithë elementët vlerësohen në përputhje me madhësinë dhe natyrën e punës dhe organizimit (ose natyrës së rekomandimeve), pa ndonjë çështje të rëndësishme për t'u trajtuar dhe rrezik të ulët dështimi nëse jepet granti.
- o **Mjaftueshëm**, në rastet kur shumica e elementeve vlerësohen në përputhje me madhësinë dhe natyrën e punës dhe organizimit (ose natyrës së rekomandimeve), megjithatë me disa elementë të rëndësishëm që duhen adresuar gjatë zbatimit për të ulur rrezikun e dështimit nëse jepet granti.
- o **Të pamjaftueshme**, në rastet kur një pjesë e konsiderueshme e elementeve vlerësohen të papërshtatshme me madhësinë dhe natyrën e punës dhe organizimit (ose natyrës së rekomandimeve), me rrezik shumë të lartë dështimi nëse jepet granti, pra nivel i papranueshëm për dhënien e grantit.

Organizatrat në listën e ngushtë që do të vlerësohet se kanë një nivel të pamjaftueshëm të qeverisjes së brendshme, menaxhimit financiar dhe adresimit të rekomandimeve të mëparshme, nuk do të ftohen për intervista publike.

Intervista e aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë përbëhet nga një prezantim i shkurtër i propozimit të grantit (5 min) dhe një seancë Pyetje dhe Përgjigje (10 min) me anëtarët e ekipit për vlerësimin e granteve.

Pas përfundimit të intervistave, Ekipi për vlerësimin e granteve rekomandon listën e aplikantëve për ndarjen e grantit për zhvillim organizativ. Për t'u konsideruar për financim, aplikantët duhet t'i marrin **së paku 71 pikë në total**, si dhe **gjysmën e pikëve në dispozicion (50%)** në secilën nga të gjashtë kategoritë e paraqitura më lart.

Lista e aplikantëve të rekomanduar për një grant do të rishikohet bazuar në fondet në dispozicion dhe kuotën gjeografike, ku të paktën 30% e përfituesve do të jenë organizata me seli dhe që veprojnë jashtë Prishtinës. Aplikacionet me rezultatin më të mirë përfundimtar brenda buxhetit total të paraparë për këtë thirrje rekomandohen për financim.

Donatorët e kanë të drejtën e vetos për aplikacionet e financuara që konsiderohen se bien ndesh me vlerat e promovuara nga donatori ose përkojnë me intervenimet të tjera të ngjashme.

Buxheti i paraparë për këtë thirrje është 75,000.00 EUR dhe numri i granteve që planifikohet të ndahen është 5. Megjithatë, në varësi të përmbushjes së kriterëve dhe cilësisë së aplikacioneve, KCSF rezervon të drejtën që të mos shpërndajë të gjitha fondet në dispozicion.

5. Vlerësimi dhe njoftimi



c. Njoftimi për vendimin dhe shqyrtimi i ankesave

Secili aplikant që ka marrë pjesë në procesin e aplikimit do të pranojë përgjigje lidhur me procesin vlerësues dhe rezultatin e aplikacionit të tyre, përfshi rezultatin e përgjithshëm. Vendimet për financim të marra nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve dhe që nuk vihen veto nga donatorët janë përfundimtare. Pas përfundimit të këtij procesi, KCSF-ja do t'i informojë aplikantët e pasuksesshëm me rezultatet e aplikimit të tyre, duke përfshirë pikët totale, pikët për kategori dhe renditjen përfundimtare. Informata të mëtejshme mund të ofrohen nga KCSF-ja vetëm me kërkesë, në formën e një përmbledhjeje të komenteve anonime nga anëtarët e Ekipit për Vlerësimin e Granteve.

Ankesa formale mund të paraqitet vetëm në rastet kur aplikantët e pasuksesshëm kanë arsye të forta për të besuar se një dokument specifik i dorëzuar nga ata është lënë jashtë procesit të vlerësimit, duke rezultuar në rezultate dukshëm më të ulëta në një kategori të caktuar ose në përgjithësi. Ankesa formale do të dorëzohet në bazë të shabllonit zyrtar të ankesës të publikuar në ueb faqen e KCSF-së **brenda dy ditëve të punës pas njoftimit nga KCSF.**

Drejtori Ekzekutiv i KCSF-së do të themelojë një komision të brendshëm për të vlerësuar nëse lëshimi i pretenduar ka ndodhur realisht, bazuar në dëshmitë e dorëzuara nga aplikanti i pasuksesshëm dhe në informatat që mund të gjurmohen nga sistemi i vlerësimit i KCSF-së. Në rast se komisioni i brendshëm konfirmon se lëshimi ka ndodhur realisht, dokumenti i hequr do të përfshihet në dosje dhe aplikacioni do të rivlerësohet nga EVG-ja dhe rezultati i ri që rezulton nga rivlerësimi do të përfshihet në renditjen përfundimtare të aplikantëve.



EJA Kosovë është program i KCSF-së që aktualisht financohet bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. KCSF-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programit, në bashkëpunim të ngushtë me donatorët finances për çështjet strategjike dhe kryesore operationale.

Vlerësimi i aplikacioneve individuale kryhet nga Ekipi për Vlerësimin e Grantëve i përbërë nga vlerësues të jashtëm, ku KCSF-ja ka rol mbështetës që përfshin elementet e mëposhtme: përcaktimi i kriterëve të vlerësimit, dizajnimi i sistemit të vlerësimit, përzgjedhja e rastësishme e anëtarëve të EVG-së nga grupi i vlerësuesve të jashtëm të kontraktuar nga KCSF-ja, realizimi i kontrollit administrativ të aplikacioneve të dorëzuara, duke organizuar vizita në terren tek aplikantët e përzgjedhur për verifikimin e dokumenteve dhe praktikave të qeverisjes së brendshme, duke vlerësuar nivelin e qeverisjes së brendshme bazuar në dokumentet e dorëzuara dhe rezultatet e vizitave në terren, vlerësimi i nivelit të përcjelljes dhe përmbushjes së kërkesave formale nga grantet e mëparshme me KCSF-në dhe/ose rekomandimet e auditimit, si dhe udhëzimet metodologjike për dhe monitorimin e anëtarëve të EVG-së për zbatimin adekuat të sistemit dhe metodologjisë së vlerësimit.

Pas vendimeve përfundimtare për financimin të marra nga Ekipi për Vlerësimin e Grantëve dhe përfundimit të procesit të vetos nga donatorët, KCSF-ja ndërmerr hapat e mëposhtëm: përgatit kontratën e grantit, mbështet përfituesin e grantit në finalizimin e dokumenteve të zbatimit (buxheti final, korniza logjike, plani i aktiviteteve) dhe planit për ngritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimin, monitoron rregullisht zbatimin e grantit, merr dhe miraton raporte periodike nga përfituesit e grantit bazuar në udhëzimet dhe modelet e raportimit, kontraktin kompanitë audituese për të kryer auditime të jashtme të grantit, organizon dhe/ose lehtëson aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimin për përfituesit e grantëve dhe komunikon me përfituesit e grantëve për çështje të ndryshme që lidhen me zbatimin me sukses të grantit.

6. Datat e rëndësishme tentative



Procesi	Data tentative
Lansimi i Thirrjes për Grante për Zhvillim Organizativ	26/05/2026
Sesion informativ	*Detajet do të publikohen në www.kcsfoundation.org dhe në faqen FB të KCSF-së
Afati i fundit për pyetje dhe sqarime	19/06/2026
Data e fundit për t'i publikuar përgjigjet	23/06/2026
Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	28/06/2026 në 23:59
Informata mbi rezultatin e kontrollit administrativ	03/07/2026
Informata mbi aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë	Gusht 2026
Vizita nga KCSF-ja tek aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë	Fundi i gushtit – fillimi i shtatorit 2026
Intervistat publike	Shtator/tetor 2026
Vendimi përfundimtar	Tetor 2026
Kontraktimi dhe fillimi i zbatimit të granteve	Nëntor 2026

